



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

---

Numri i lëndës: 2021:074405

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05439613

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorëve L.I., B.A., V.N., B.M., dhe D.ZH., që të gjithë nga Gjakova, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj avokat në Prishtinë, kundër debitores së përmbarimit Komunes së Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për përmbarimin e dokumentit të ekzekutueshëm – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.499/21 të datës 05.01.2023, për shkak të kompensimit e ushqimit dhe udhëtimit në punë, dhe për klasë të kombinuar, në shumën e përgjithshme prej 26,616.09 euro, duke vendosur për debitimin e mjeteve përmes xhirollogarisë bankare, jashtë seancës gjyqësore, më 12 mars 2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. URDHËROHET Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës në Prishtinë – Llogaria e vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar me Aktvendimin e kësaj gjykate, 2021:074405 të datës 02.06.2023, për lejimin e përmbarimit të dokumentit të ekzekutueshëm - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.499/21, të datës 05.01.2023, për shkak të kompensimit e ushqimit dhe udhëtimit në punë, dhe për klasë të kombinuar, dhe atë:

- kreditorit L.I., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 7,738.74 euro,
- kreditorit B.A., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 7,739.25 euro,
- kreditorit V.N., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 2,145.38 euro,

- kreditores B.M., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 2,466.36 euro,

- kreditores D.ZH., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 2,466.36 euro,

si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbarimore në shumën prej 4,061.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 26,616.09 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, në atë mënyrë që nga xhirollogaria e debitorës së përmbarimit, Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të barten këto mjetet monetare, në llogarinë e të autorizuarit të kreditoreve avokat Arben Biblekaj, në xhirollogarinë e tij bankare, me Nr....., në Bankën Kombëtare Tregtare-BKT.

II. OBLIGOHET pala kreditore dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Llogaria e vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën ta njoftoj me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e mos zbatimit të tij.

### A r s y e t i m

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të kreditores së përmbarimit, me aktvendimin 2021:074405, të datës 02.06.2023, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit. Ndaj këtij aktvendimi, debitorja ka ushtruar prapësim me datë 16.06.2023, ndërsa i autorizuari i kreditoreve me datë 27.06.2023 ka paraqitur përgjigje në prapsim. Duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorës, gjykata me aktvendim 2021:074405, të datës 24.10.2023 ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e lartcekur.

Meqenëse palët kreditore në propozimin e tyre për përmbarim, kanë cekur mjetin e përmbarimit kreditorit L.I. nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 7,738.74 euro, kreditorit B.A., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 7,739.25 euro, kreditorit V.N., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 2,145.38 euro, kreditores B.M., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 2,466.36 euro, kreditores D.ZH., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 2,466.36 euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbarimore në shumën prej 4,061.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 26,616.09 euro, dhe atë për këto arsye:

Nga shikimi i shkresave të lëndës, 2021:074405, kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret pjesë e detyrimit që rrjedh nga dokumenti i përmbarimit – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.499/21, të datës 05.01.2023, i plotfuqishëm me datë 25.01.2023, dhe i ekzekutueshëm me datë 03.02.2023, për shkak të detyrimit në të holla, duke u bazuar në dokumentin e lartcekur të përmbarimit, si dhe nenin 152 të LPP-së, debitorja, është e obliguar që kreditoreve të përmbarimit, t'ia paguaj shumat e lartcekura të gjitha në afat prej 7 ditësh, andaj në arsyet e cekura më lart kjo gjykatë, vendosi që ta urdhëroj Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë - Llogarinë e Thesarit, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat, gjykata duke u bazuar në nenet 3, 5 par.6 pika 2, 109 par.3, 113 dhe nenin 152 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

- Departamenti i Përgjithshëm-

2021:074405, më 12 mars 2024

GJYQTARI,

Durim BALAJ

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e veçantë.